



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-15923/20 datë:19.08.2020



Npi – 01/181 datë: 31.08.2020

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën me numër: Nr.01-070/05-12156/20 datë:15.07.2020, të z.Ymri Imeri – Raqak, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes ka kërkuar, shpronësimin e pronës së paluajtshme me sipërfaqe prej 73 m² në Parcelën 761-2 Zona Kadastrale – Raqak. Prona është marrë nga Komuna me qëllim të zgjerimit të rrugës “15 Janari” dhe trotuarit në drejtim të Kompleksit Përkujtimor të Masakrës së Raçakut.

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) dhe 17 pika (f) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr 28/2008); Nenit 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin 03/L-205 të datës 28 tetor 2010, Kuvendi Komunës, pasi analizoi kërkesën e palës, Rekomandimet e Drejtorisë dhe Komitetit për Politikë e Financa, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E PRONËS ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VI- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 31.08.2020, unanimisht aprovoi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm, pjesën e Ngastrën Kadastrale Nr.761-2, me sipërfaqe prej 73m² (shtatëdhjetë e tri metra katror), në Zonën Kadastrale – Raçak, Evidentuar pronë e Ymri / Shefqet / Imeri, nga fshati Raçak.

II

A r s y e t i m: Shpallja me interes të përgjithshëm të pjesës të Ngastrës Kadastrale me numër Nr.761-2, me sipërfaqe prej 73 m², është bërë me qëllim të zgjerimit të rrugës “15 Janari” në fshatin Raçak. Shpronësimi i kësaj prone do të trajtohet sipas Ligjit nr 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimin dhe plotësimet e bëra me Ligjin 03/L-205. Sipërfaqja e cila është shfrytëzuar nga Komuna e Shtimes për rrugë, sipas matjeve gjeodezike është 73m² të kryera në bazë të kërkesës së palës, po ashtu nga zyra e Kadastrit është definuar se sipërfaqja për shpronësim është rruga së bashku me bankinë.

III

Me këtë vendim obligohet ekzekutivi i Komunës së Shtimes që të fillojë procedurat e Shpronësimit, sipas Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtoris, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj